

Instituti për Studime të Avancuara GAP

# Letërnjoftimi i Komunës së Podujevës 2013

Prill 2013

*“Letërnjoftimi i Komunave”* është projekt i Institutit GAP i cili vlerëson qeverisjen komunale tri vite pas zgjedhjeve lokale të 2009. Ky projekt është implementuar në bashkëpunim me Rrjetin Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) dhe Qendrën e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim (ATRC). Rezultatet e hulumtimeve të GAP për qeverisjen komunale janë debatuar me kryetarët e komunave në emisionet “Jeta në Kosovë”.

## Përmbajtja

Përmbledhje ekzekutive .....	3
1. Hyrje.....	4
2. Problemet në Komunën e Podujevës .....	5
3. Performanca buxhetore e Komunës së Podujevës.....	7
4. Investimet kapitale.....	11
5. Aktivitetet e Prokurimit Publik.....	13
6. Administrata e Komunës së Podujevës .....	15
7. Arsimi në Komunën e Podujevës.....	16
8. Shëndetësia në Komunën e Podujevës.....	17
9. Transparenca në Komunën e Podujevës.....	17
10. Përbushja e premtimeve të fushatës zgjedhore 2009 .....	20
11. Burimet.....	25

## Përmbledhje ekzekutive

Komuna e Podujevës, e cila udhëhiqet nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) gjatë tri viteve të fundit, 2010-2012, është karakterizuar me një qeverisje më dinamike krahasuar me periudhat e mëhershme, por problemet mbesin evidente në shumë fusha të jetës. Kushtet në disa shkolla janë jo të mira, mungon uji i pijes në shumë zona, si dhe gjatë këtyre tri viteve të fundit në disa raste është vërejtur pasivitet i organeve komunale për t'i adresuar nevojat dhe shqetësimet e qytetarëve nga disa vendbanime të Podujevës.

Gjatë tri viteve të kaluara janë hasur shpenzime të mëdha të parasë publike në disa kategori. Është evidentuar nivel tejet i lartë i shpenzimit të parasë nga Komuna e Podujevës për mbeturina si dhe karburante për gjenerator, për vetura, naftë për ngrohje, telefona mobil dhe fiks si dhe në mirëmbajtjen e veturave zyrtare. Kësisoj, Podujeva për një vit paguan deri në 103.000 euro për energji elektrike, shumë kjo e përafërt me shpenzimet që bën komuna për t'i paguar faturat e mbeturinave. Gjatë këtyre tri viteve, Komuna e Podujevës ka shpenzuar 70.853 euro për karburant për gjenerator, 251.318 euro naftë për ngrohje, 67.283 euro për mirëmbajtjen dhe riparimin e automjeteve, 106.810 euro për telefonat mobil dhe fiks, dhe 262.170 euro karburant për vetura. Kryetari dhe nënkryetari i Podujevës banojnë në Prishtinë dhe për çdo ditë me veturë zyrtare udhëtojnë nga Prishtina për në Podujevë dhe anasjelltas.

Komuna e Podujevës qëndron më së keqi në krahasim me komunat e mëdha të vendit për sa i përket përfaqësimit të femrës në pozitat e punës. Përveç që nuk është emëruar ndonjë femër për të udhëhequr ndonjërin nga dhjetë drejtoritë, numri i femrave është i vogël edhe në dikasteret tjerë të Komunës, ku nga 262 të punësuar në Komunën e Podujevës vetëm 46 prej tyre janë femra. Numri i femrave të punësuar është i vogël edhe në sistemin arsimor dhe atë shëndetësor të kësaj komune. Megjithatë, kjo komunë ka shënuar progres në disa aspekte, sikurse përmirësimi i dukshëm i pamjes së qytetit, rregullimi i infrastrukturës rrugore, rritja e transparencës komunale ndaj qytetarëve, etj.

Në këtë raport, i cili mbulon zhvillimet rreth politikave publike në komunën e Podujevës për periudhën janar 2010 - shtator 2012, Instituti GAP ka përmendur problemet më të mëdha me të cilat përballen qytetarët, ka analizuar performancën buxhetore, investimet kapitale, aktivitetet e prokurimit publik, gjendjen në administratë, arsim dhe shëndetësi, transparencën e Komunës, si dhe ka matur realizueshmërinë e premtimeve të dhëna gjatë fushatës zgjedhore 2009.

## 1. Hyrje

Komuna e Podujevës udhëhiqet nga z. Agim Veliu, i cili pozitën e të parit të komunës e ka fituar duke përfaqësuar subjektin politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK). Z. Veliu pozitën e njëjtë të Kryetarit të Komunës e ka ushtruar edhe në periudhën e parë të pas luftës 2000-2002 për t'u rizgjedhur sërish si kryetar në vitin 2002-2004. Pas kësaj periudhe z. Veliu ka shërbyer në pozitën e Ministrit të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, ndërsa nga viti 2007 deri në zgjedhjet lokale të vitit 2009 ka mbajtur pozitën e deputetit të Kuvendit të Kosovës nga radhët e LDK-së. Në zgjedhjet e fundit z. Veliu është zgjedhur Kryetar Komune direkt në raundin e parë me 52% të votave.

Në regjistrimin e fundit të popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave, Komuna e Podujevës ka dalë t'i këtë 88.499 banorë.<sup>1</sup> Kjo shifër nuk përkon me pritjet e autoriteteve të kësaj komune, të cilët kanë supozuar së Komuna e Podujevës ka rreth 130.000 banorë.<sup>2</sup> Ndërsa, granti që ndahet për komuna nga Qeveria e Kosovës, kësaj komune i është ndarë për 117.000 banorë, apo për 29.000 banorë më shumë.<sup>3</sup> Nga viti i ardhshëm, Qeveria e Kosovës ka paralajmëruar marrjen parasysh të rezultateve të regjistrimit të popullsisë në ndarjen e granteve, që nënkupton se Podujevës pritet t'i t'kurret buxheti për rreth 180.000 euro.<sup>4</sup>

Ekzekutivi i Komunës së Podujevës përbëhet prej 11 drejtorive dhe 12 zyrave. Drejtoritë janë: Drejtoria e Administratës, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Drejtoria e Arsimit, Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Drejtoria e Planifikimit Urban, Drejtoria për Pronë dhe Kadastër, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Drejtoria e Inspektionit, Drejtoria e Bujqësisë dhe e Zhvillimit Rural dhe Drejtoria për Planifikim dhe Zhvillim Ekonomik. Ndërsa zyrat janë: Zyra e Kryetarit, Zyra e Personelit, Zyra Pritëse, Zyra e Gjendjes Civile, Zyra e Auditimit, Zyra për të Drejtat e Njeriut, Zyra për Komunitete dhe Kthim, Zyra për Informim, Zyra për Integritet Evropian, Zyra Ligjore, Zyra për Konteste Juridike dhe Zyra për Teknologji Informativë. Asnjëra nga 11 Drejtoritë ekzistuese nuk udhëhiqet nga femrat.

Ekzekutivi i Komunës së Podujevës nuk ka hyrë në koalicion bashkëqeverisje me subjektet tjera politike, sepse pjesa dërrmuese e asamblistëve janë nga Lidhja

---

<sup>1</sup>Agjencia e Statistikave të Kosovës. Rezultatet përfundimtare për Regjistrimin e Popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave - 2011. Burimi: [http://esk.rks-gov.net/rekos2011/repository/docs/Te%20dhenat%20kryesore\\_ALB.pdf](http://esk.rks-gov.net/rekos2011/repository/docs/Te%20dhenat%20kryesore_ALB.pdf)

<sup>2</sup>Komuna e Podujevës. Ueb faqja zyrtare. Demografia e Komunës së Podujevës. Burimi: <http://kk.rks-gov.net/podujeve/City-guide/Geography.aspx>

<sup>3</sup>Kuvendi i Kosovës. Ligji për Financat e Pushtetit Lokal. Burimi: [http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2008\\_03-L049\\_al.pdf](http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2008_03-L049_al.pdf)

<sup>4</sup>Instituti për Studime të Avancuara GAP. Të dhënat e Regjistrimit të Popullsisë dhe ndikimi i tyre në Politikën Publike. Burimi: <http://institutigap.org/repository/docs/GAPanalizepertedhenateASK.pdf>

Demokratike e Kosovës. Kësisoj, nga gjithsej 41 asambleistë sa numëron Kuvendi i Podujevës, 19 prej tyre janë nga LDK, 12 nga PDK, gjashtë nga AAK, një i Partisë së Drejtësisë, një nga Partia Social Demokrate, një i AKR dhe një përfaqësues nga Iniciativa Qytetare e Podujevës.<sup>5</sup> Në ndërkohë, përfaqësuesi i Partisë Social Demokratike (PSD) i është bashkangjitur PDK duke e rritur këtë subjekt politik në Kuvendin e Podujevës në 13 asambleistë, ndërsa LDK-së i është bashkangjitur përfaqësuesi i AKR-së duke e rritur numrin e LDK në Kuvendin e Podujevës në 20. LDK ndonëse formalisht nuk ka ndonjë koalicion me përfaqësuesit e PD dhe IQP në Kuvend, përgjithësisht llogarit në votat e tyre pro vendimeve që i sjell në Kuvend ekzekutivi.

## 2. Problemet në Komunën e Podujevës

Përveç problemeve që ndërlidhen me çështjet ekonomike, banorët e Komunës së Podujevës aktualisht përballen edhe me probleme të cilat janë përgjegjësi e nivelit komunal për t'u zgjidhur. Ndër problemet më madhore të kësaj komune janë: kushtet e vështira në disa shkolla, mungesa e ujit të pijshëm në shumë zona, mungesa e vend parkingjeve, mos asfaltimi i shumë rrugëve të komunës, mos pastrimi i trotuareve, mos sanimi i shtratit të lumit Llap në pjesën dërrmuese të tij, etj.

Në janar të këtij viti, disa banorë të Podujevës me vetë iniciativë kanë ndërmarrë aksion për pastrimin e trotuareve nga balta në afërsi të urës që shpie në drejtim të pikës kufitare në Merdar. Kjo iniciativë e tyre ka ardhur pas neglizhencës së autoriteteve komunale për të bërë pastrimin e këtyre trotuareve. Iniciativa e banorëve ka ardhur pasi që ishte vlerësuar si tejet e rrezikshme pamundësia e fëmijëve për ta shfrytëzuar trotuarin gjatë rrugës për në shkollë. Vërejtjet e banorëve janë edhe për mos iniciativën e zyrtarëve komunal për të vendosur pengesa në disa rrugë të cilat do të ngadalësonin shpejtësinë e automjeteve për të evituar aksidentet e mundshme të cilat në rajonin e Podujevës nuk janë të pakta.

Një ankesë tjetër e banorëve ka të bëjë me kushtet jo të mira në shkollat e këtij lokaliteti. Në gjendje të tillë gjendet shkolla fillore "Shefki Kuleta" në fshatin Halabak si dhe shkolla "Pavarësia" në fshatin Sibovc të Podujevës. Familjarët e nxënësve të shkollës "Pavarësia" i kanë ndaluar fëmijët e tyre të shkojnë në shkollë për disa ditë në gjysmën e dytë të janarit të këtij viti si shenjë proteste dhe mllefi për mos rregullimin e shkollës dhe kushteve të këqija që mbizotërojnë në atë objekt arsimor.

Edhe pse në territorin e Podujevës gjendet liqeni i Batllavës, i cili furnizon me ujë të pijshëm pjesën më të madhe të Prishtinës, vetë Podujeva në tri vitet e fundit ka pasur

<sup>5</sup> Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Rezultatet përfundimtare për Kuvendet komunale nga zgjedhjet lokale të vitit 2009. Fq 19. Burimi: <http://www.kqz-ks.org/SKQZ-WEB/al/zgjedhjetekosoves/materiale/rezultatet2009/komune/ResultsByMunicipality.pdf>

probleme të theksuara nga mungesa e ujit të pijes. Reduktimet e ujit në qytet gjatë verës kanë shkuar deri në tetë orë në ditë. Sipas autoriteteve komunale mungesa e ujit është si pasojë e keqpërdorimit nga banorët e fshatrave të cilët ujin e përdorin për ujitjen e kopshteve dhe arave.

Komuna e Podujevës gjatë tri viteve të kaluara ka investuar në rregullimin e shtratit të lumit Llap për të parandaluar daljen e lumit nga shtrati. Gjithashtu, komuna është përkujdesur edhe për mirëmbajtjen e shtratit të lumit. Por, gjatësia relativisht e madhe e lumit ka pamundësuar investimet e përnjëhershme dhe kësaj në disa fshatra të Podujevës ka pasur raste kur fëmijët kanë rënë në lum, disa prej të cilëve e kanë humbur jetën. Nga ky problem më të prekur janë fshati Lupç i poshtëm, Zhiti, Lluzhan dhe pjesërisht fshati Barilevë.

Investimet nga ana e Komunës së Podujevës në rregullimin e infrastrukturës rrugore kanë qenë të konsiderueshme në tri vitet e fundit, por ende ka probleme të kësaj natyre në shumë zona të Podujevës. Rrugë me baltë mund të hasen edhe në zonat urbane, siç është rruga "Bedri Bajrami". Banorët e kësaj lagje i janë drejtuar disa herë me kërkesa zyrtarëve komunal më qëllim të asfaltimit të rrugës së tyre. Kërkesa të njëjta kanë adresuar edhe banorët e disa lokaliteteve tjera në Podujevë, si nga fshati Dyz, Dumosh, Pakashiticë, Kërpimeh, Herticë, Sveqël, Pollatë.

Gjatë tri viteve të kaluara, 2010-2012, pamja e qytetit të Podujevës ka ndryshuar thellësisht për të mirë dhe krejt kjo falë investimeve të përbashkëta të Komunës së Podujevës dhe Zyrës Ndërlidhëse të Komisionit Evropian në Kosovë (ZNKE). Rregullimi i shtratit të lumit që përshkon qytetin, gjelbërimi përreth tij, instalimi i ndriçimit si dhe rregullimi i ulëseve për qytetarët i ka dhënë një imazh të ri qytetit. Por, kjo nuk është shoqëruar edhe me gëlqerosjen e të gjitha ndërtesave publike në qendër të qytetit, veçmas atyre përgjatë rrugës "Afrim Zhitia" dhe "FazliFazliu". Mos gëlqerosja e këtyre ndërtesave zbeh imazhin e mirë të qytetit të krijuar nga rregullimi i lumit. Banorët në ndërtesat publike në qendër të qytetit përballën edhe me mungesë ashensorësh, ndriçim nëpër korridore, mungesë të anësoreve nëpër shkallë si dhe mungesë të pajisjeve për fikjen eventuale të zjarrit.

Në Komunën e Podujevës problem konsiderohet edhe vendbanimi jo formal në këtë qytet i njohur ndryshe edhe si "lagja e Kuvajtit" ku jetojnë afro 140 familje në kontejnerë. Mos pagimi i rrymës, ujit dhe mbeturinave nga banorë të kësaj lagje ka ndikuar keq edhe në pjesët tjera të qytetit.

### 3. Performanca buxhetore e Komunës së Podujevës


Në bazë të regjistrimit të fundit të popullsisë, Komuna e Podujevës kategorizohet në mesin e komunave të mëdha të vendit, me popullatë më të madhe se Skenderaj, Drenasi, Mitrovica, Vushtrria, Suhareka, Rahoveci. Podujeva për nga numri i popullsisë është më e përafërt me Komunën e Gjilanit.<sup>6</sup>

Nga 16.521,350 euro të buxhetit të Komunës së Podujevës për këtë vit, për paga janë të parapara 54%, 34% për investime kapitale, 6.6% për mallra dhe shërbime, 1.8% për shpenzime komunale dhe 1.9% për subvencione.

Tabela nr.1: Shuma totale e buxhetit të Komunës së Podujevës dhe pesë komunave tjera të vendit -2013

Komunat	Podujevë	Gjilan	Skenderaj	Suharekë	Rahovec	Mitrovicë
<b>Shuma (Euro)</b>	16.521,350	18.418,682	9.984,328	12.281,590	9.774,525	15.108,605

Grafikoni nr.1: Shpërndarja e buxhetit nga Komuna e Podujevës për vitin 2013.<sup>7</sup>



<sup>6</sup>Komuna e Podujevës në bazë të regjistrimit ka dalë t'i këtë 88.499 banorë, Gjilani 90.178 banorë. Agjencia e Statistikave të Kosovës. Rezultatet përfundimtare për Regjistrimin e Popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave - 2011. Burimi: [http://esk.rks.gov.net/rekos2011/repository/docs/Te%20dhenat%20kryesore\\_ALB.pdf](http://esk.rks.gov.net/rekos2011/repository/docs/Te%20dhenat%20kryesore_ALB.pdf)

<sup>7</sup>Instituti për Studime të Avancuara GAP. Si i shpenzon shteti paratë tona. Komuna e Podujevës. Burimi: <http://www.institutigap.org/spendings/?podujeve/2013#/~/~podujeve>

Linja e të hyrave	Shuma/euro		
	2012	2011	2010
Nga tatimi në pronë	296.286	322.130	256.685
Nga regjistrimi i automjeteve	99.851	102.630	90.824
Nga taksa në parking	00	1.864	00
Nga gjobat në trafik	12.920	30.505	29.305
Nga lejet e ndërtimit	148.447	58.501	179.582
Nga regjistrimi i trashëgimisë	40.410	38.615	41.000
Nga ndërrimi i destinimit të tokës	43.302	1.930	38.954
Nga certifikatat e lindjes	20.841	24.342	40.668
Nga certifikata e kurorëzimit	6.869	8.584	6.475
Nga certifikata e vdekjes	112	67	73
Nga certifikatat tjera të ofiqarisë	17.019	19.349	13.407
Nga vërtetimi i dokumenteve	4.674	4.006	3.178
Nga taksat administrative	56.676	56.001	63.413
Nga pjesëmarrja në tender	00	420	9.930
Nga gjobat e gjykatave	37.720	60.387	81.875
Taksë për shtetësi	5.827	5.627	1.246
Nga marrja e automjeteve në rrugë	4.425	00	00
Gjobat tjera	16.000	1.561	1.489
Nga pranimet teknike të lokaleve	120	2.330	00
Nga licenca për dyqanet e mëdha	105.660	114.552	121.172
Nga shitja e mallrave	3.593	963	00
Qiraja nga objektet tregtare	00	51.640	36.665
Nga matja e tokës	00	14.359	00
Qiraja nga objektet publike	48.480	00	00
Të hyrat nga shëndetësia dhe arsimi	140.826	123.162	86.565
Të hyra nga shitja e pasurisë	8.801	00	00
Nga agjencia e pyjeve	00	50	9.284
Nga inspekcioni në terren	18.505	00	11.217
<b>Gjithsej</b>	<b>1.137,364</b>	<b>1.043,575</b>	<b>1.123,007</b>

Edhe për kundër rritjes së lehtë të të hyrave komunale, Auditori i Përgjithshëm në raportin për vitin 2011 ka evidentuar mos efikasitet në këtë pikë. Sipas këtij institucioni, Komuna e Podujevës nuk ka arrit t'i menaxhojë mirë të hyrat vetanake. Sipas Auditorit, planifikimi i të hyrave është jo i duhur, ngase shumat e detyrimeve tatimore të pa paguara janë të larta dhe komuna nuk ka ndërtuar një plan se si të përmirësohet kjo



gjendje. Në bazë të Auditorit, vetëm komuniteti i biznesit i ka borxh komunës afro 3 milionë euro.<sup>8</sup>

Sipas raporteve financiare të Ministrisë së Financave, në dy vitet e fundit Komuna e Podujevës nuk ka pasur shuma të larta borxhesh apo fatura të pashlyera ndaj operatorëve privat. Kësisoj, 2012 ka nisur me 133.972 euro fatura të papaguara, përderisa 2013 ka nisur me mbi 233.000 euro fatura te papaguara. Lista e faturave të papaguara rezulton të jetë kryesisht me mos pagimin e derivateve, botimeve, publikimeve, mirëmbajtjes së objekteve dhe automjeteve dhe kategorive tjera në linjën e mallrave dhe shërbimeve. Kjo Komunë, në linjën për mallra dhe shërbime gjatë një viti ka në dispozicion rreth 1.1 milionë euro.

Tabela nr.3: Shpenzimet në disa kategori në linjën për mallra dhe shërbime në Komunën e Podujevës për vitin 2011

Kategoria	Shuma
Shpenzime për telefon mobil	12.770
Shpenzimet për telefon fiks	20.833
Derivate për automjetet zyrtare	69.754
Shpenzimet e marketingut	15.086
Dreka zyrtare	9.555
Naftë për gjenerator	28.267
Naftë për ngrohje	102.630

Tabela nr.4: Krahasimi i shpenzimeve në disa kategori mes vitit 2010 dhe atij 2011 në Komunën e Podujevës

Kategoria	Shuma	
	2010	2011
Shpenzime - mëditje/udhëtime	7.130	6.470
Naftë për ngrohje	94.056	102.630
Karburant për gjenerator	26.346	28.267
Karburant për automjete zyrtare	58.626	69.754
Mirëmbajtja e automjeteve	8.792	23.921
Dreka Zyrtare	9.953	9.555
Mirëmbajtja e ndërtesave	15.884	16.620
Furnizim i zyrave	179.255	140.926
Blerja e druve dhe thëngjillit	147.283	113.523
Telefoni mobile	8.350	12.770
Telefoni fikse	27.725	20.833

<sup>8</sup>Zyra e Auditorit të Përgjithshëm. Raporti i Auditimit për Pasqyrat Financiare të Komunës së Podujevës për vitin 2011. Fq 14. Burimi: [http://www.oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit\\_KPD\\_2011\\_Shqip\\_309305.pdf](http://www.oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit_KPD_2011_Shqip_309305.pdf)

Auditori, në raportin për vitin 2011, ka gjetur anomali në Komunën e Podujevës për sa i përket sasisë së naftës të pranuar nga ana e autoriteteve në Podujevë.<sup>9</sup> Një nga rekomandimet e këtij institucioni për Komunën e Podujevës është që të tregohet e kujdesshme në mbajtjen e dëshmive të qarta për pranimin dhe argumentimin e mallrave të blera.

Ndërsa në kategorinë tjetër buxhetore, atë për shpenzimet komunale, mbeten të pashpjeguara shifrat e njëjta të shpenzuara nga Komuna e Podujevës si për energji elektrike ashtu edhe për mbeturina.

Tabela nr.5: Prezantimi i shpenzimeve në linjën e shpenzimeve komunale për vitin 2012 dhe krahasimi me vitin 2011 dhe 2010

Kategoria	2010	2011	2012
Pagesat për energji elektrike	121.752	103.417	127.737
Pagesat për ujë	33.079	52.609	47.571
Pagesat për mbeturina	108.434	103.947	82.721

Shpenzimet e bëra nga Komuna e Podujevës gjatë vitit 2012 nxjerrin në pah se në disa kategori janë hasur shpenzime me shifra të larta.

Tabela nr.7: Vlerësimi i totalit të shpenzimeve gjatë tri viteve në disa kategori nga Komuna e Podujevës

Kategoria	2010	2011	2012	Gjithsej
Dreka Zyrtare	9.953	9.555	9.295	<b>28.803</b>
Telefoni mobile	8.350	12.770	11.759	<b>32.879</b>
Telefoni fikse	27.725	20.833	25.373	<b>73.931</b>
Mëditje jashtë vendit	7.130	6.470	3.077	<b>16.677</b>
Naftë për ngrohje	94.056	102.630	54.632	<b>251.318</b>
Karburant për automjete zyrtare	58.626	69.754	133.790	<b>262.170</b>
Karburante për gjenerator	26.346	28.267	16.240	<b>70.853</b>
Mirëmbajtja e automjeteve	8.792	23.921	34.570	<b>67.283</b>

Kryetari i Podujevës banon në Prishtinë në lagjen “Bregu i diellit” dhe për çdo ditë me veturë zyrtare udhëton nga Prishtina për në Podujevë dhe anasjelltas. Edhe nënkryetari i këtij institucioni Agim Kika banon në Prishtinë dhe për çdo ditë të punës udhëton me veturë zyrtare për vajtje-ardhje në punë. Kryetari Veliu banesën në lagjen “Bregu i

<sup>9</sup>Zyra e Auditorit të Përgjithshëm. Raporti i Auditimit për Pasqyrat Financiare të Komunës së Podujevës për vitin 2011. Fq 16. Burimi: [http://www.oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit\\_KPD\\_2011\\_Shqip\\_309305.pdf](http://www.oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit_KPD_2011_Shqip_309305.pdf)

Diellit” e ka te deklaruar edhe në formularët për deklarimin e pasurisë pranë Agjencisë Kundër Korrupsion.<sup>10</sup>

Në muajin qershor 2012, një firmë projektuese u ka kërkuar banorëve të dy Llapashticave në Podujevë (Llapashtica e epërme dhe ajo e poshtme) nga 25 euro për shtëpi me qëllim të projektimit të planit për kanalizimin e fshatit. Të dyja fshatrat kanë afërsisht 600 shtëpi dhe nëse kjo shifër llogaritet me 25 euro, atëherë i bie mbi 15.000 euro, shumë kjo relativisht e lartë për projektimin e një plani. Kjo punë do të duhet iniciuar dhe financuar nga Komuna dhe jo nëpërmjet këshillave të fshatrave. Po ashtu defekt në këtë drejtim paraqet fakti që paratë janë kërkuar vetëm për projektimin e kanalizimit, jo edhe të ujësjellësit dhe infrastrukturës tjetër përcjellëse.

#### 4. Investimet kapitale

Investimet kapitale në Komunën e Podujevës janë fokusuar kryesisht në rregullimin e rrugëve duke përfshirë rehabilitimin, asfaltimin dhe pjesërisht ndriçimin e tyre. Mbeten të pamjaftueshme investimet në zgjerimin e rrjetit të ujësjellësit si dhe në rregullimin e kanalizimeve. Shuma e përgjithshme e buxhetit vjetor që ka në dispozicion Komuna e Podujevës për investime kapitale sillet rreth 5.8 milionë euro.

Tabela nr. 8: Disa nga investimet kapitale të Komunës së Podujevës të realizuara gjatë vitit 2010 -2011 dhe 2012

Projektet kryesore të realizuara gjatë 2012	Shuma (euro)
Asfaltimi i rrugëve anësore lagjja “Visoka” dhe lagjja “Ilazi” në fshatin Kaqybeg	26.220
Ndërtimi i urës në Popovë	9.612
Ndërtimi i kanalizimit fekal në Shajkofc - Sfeqël	21.816
Asfaltimi i rrugës në fshatin Revuq – lagjja “Sinani”	38.184
Asfaltimi i rrugës nëObranqë – lagjja “Idrizi”	105.616
Asfaltimi i rrugës në fshatin Lluzhan, lagjja “Maloku” dhe “Stublla”	73.159
Ndërtimi i rrugës dhe ndërtimi i kanalizimit atmosferik nëDvorisht	28.268
Asfaltimi i rrugës në fshatin Dumnicë	13.527
Ndërtimi i kanalizimit fekal në Bajqinë – lagjet “Shala” dhe “Reqica”	15.994
Ndërtimi i kanalizimit fekal në fshatin Lupç i Poshtëm – lagjja “Kaçiu” dhe “Sokaku i vjetër”	17.633
Asfaltimi i rrugës dhe ndërtimi i kanalizimit fekal në fshatin Sfeqël	422.107


<sup>10</sup> Agjencia Kundër Korrupsionit. Deklarimi i pasurisë. 2010. Burimi: [http://akk-ks.org/2010/Komunat\\_e\\_Republikes\\_se\\_Kosoves/Podujeve/2010\\_Agim%20Veliu%20-%20Kryetar%20i%20Komunes.pdf](http://akk-ks.org/2010/Komunat_e_Republikes_se_Kosoves/Podujeve/2010_Agim%20Veliu%20-%20Kryetar%20i%20Komunes.pdf)

Asfaltimi i rrugës lagjja "Qerimi" në fshatin Sibofc i Ulet	24.048
Ndërtimi i kanalizimit fekal në fshatrat Bellopojë, Tërrnavë dhe Halabak	211.350
Asfaltimi i rrugës dhe ndërtimi i kanalizimit fekal në fshatin Bradash - lagjja "Spahiaj"	99.854
Ndërtimi i urës në fshatin Repë	13.950
Asfaltimi i rrugës në fshatin Llapashticë, lagjet "Lisi i madh", "Hodollet" dhe "Bajraktaret"	62.527
Ndërtimi i kanalizimit fekal në Dobatine, LepajëdheBajçine	222.031
Ndërtimi i rrugës Orllan - Kushevice (faza e parë)	73.539
Ndërtimi i kanalizimit fekal në Shajkofc	31.309
<b>Projektet kryesore të realizuara gjatë 2011</b>	<b>Shuma (euro)</b>
Ndërtimi i kanalizimit fekalKatunisht - Obranq	243.640
Asfaltimi i rrugës në fshatin Orllan - lagjja "Gajtanëve"	81.728
Asfaltimi i rrugës në fshatin Sibofc i Epërm lagjja "Gjaka"	39.023
Ndërtimi i urës në fshatin Sibofc	19.304
Ndërtimi i kanalizimit atmosferik në Letanc	34.963
Asfaltimi i rrugës në fshatin Surkish - 'Faza II'	138.988
Asfaltimi i rrugës në fshatin Batllavë - lagjja "Bajraktari" 'Faza II'	154.613
Asfaltimi i rrugës në lagjen "Dushi" dhe "Menxhiqi" 'Faza II' në Lupç i Epërm	128.306
Asfaltimi i rrugës në fshatin Zakut	55.991
Asfaltimi i rrugës Orllan - Brainë	376.330
Asfaltimi i rrugës në Peranlagja "Talla"	55.224
Asfaltimi i rrugës në Bajçinëlagja "Mavriqi"	116.385
Ndërtimi i urës mbi lumin Llap në Parkun e qytetit	34.817
Rregullimi i lumit Llap- 'Faza e dytë'	230.322
Ndërtimi i urës në fshatin Metehi	15.481
<b>Projektet kryesore të realizuara gjatë 2010</b>	<b>Shuma (euro)</b>
Ndërtimi i kanalizimit fekal në fshatin Dumnicë e Poshtme	128.767
Ndërtimi i trotuareve në rrugën "Skenderbeu", "Lordi Bajron" dhe rrugën "BahriFazliu"	85.837
Ndërtimi i kanalizimit fekal në Ballofc - lagjet "Bunjaku", "Zebica" dhe "Kaqandolli"	56.537
Ndërtimi i urës fshatin Batllavëlagja e "Barainëve"	11.880
Ndërtimi i kanalizimit fekal dhe asfaltimi i rrugës "Dëshmorët" në Podujevë	235.935
Ndërtimi i rrugës në fshatin Bajçinë lagja "Mavriqi" 'Faza I'	26.921
Asfaltimi i rrugës "Tetova" në Podujevë	58.399,
Ndërtimi i kanalizimit fekal në Kërpimëh	67.274
Asfaltimi i rrugës "SejdiSekiraqa" në Podujevë	53.801
Rekonstruimi i rrugës "AliAjeti" nga udhëkryqi i rrugës "Bedri Bajrami" deri të ura mbi magjistrale	144.100
Rregullimi i lumit Llap 'Faza e parë'	116.309

Ndërtimi i kanalizimit fekal në fshatin Dobërdol -lagja "Selmani"	26.891
Asfaltimi i rrugës "Haxhi Sadria" në Podujevë	66.363
Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit në Dumnicë të Poshtme	48.077
Ndërtimi i kanalizimit në fshatin Ballofc	36.460
Ndërtimi i kanalizimit fekal në rrugën "EminDuraku" në Podujevë	18.899

Edhe për vitin 2013 pjesa më e madhe e investime kapitale do të dedikohet në rregullimin dhe asfaltimin e rrugëve. Në këtë kategori janë dedikuar 50.1% e mjeteve nga investimet kapitale, apo 2.9 milionë euro. Kategoria e dytë që merr pjesën më të madhe të buxhetit të Podujevës për investime kapitale është rregullimi i kanalizimit, ujësjellësit si dhe mirëmbajtja e rrugëve ku janë ndarë mbi 1.1 milionë euro.

Grafikoni nr.2: Shpërndarja e investime kapitale nga Komuna e Podujevës për vitin 2013<sup>11</sup>



## 5. Aktivitetet e Prokurimit Publik

<sup>11</sup> Instituti për Studime të Avancuara GAP. Si i shpenzon shteti paret tona. Komuna e Podujevës. Investimet kapitale Burimi: <http://www.institutigap.org/spendings/?podujeve/2013#/~podujeve/shpenzimet-kapitale>

Komuna e Podujevës fushën e prokurimit publik e ka të rregulluar në nivel të zyrës e cila sipas organogramit funksionin brenda Drejtorisë së Administratës. Kjo zyre ka gjithsej pesë persona të punësuar, ku njëri nga ta mban pozitën e Shefit të Zyrës së Prokurimit. Për tri vite, 2010-2012, Komuna e Podujevës ka lidhur 438 kontrata nëpërmjet procedurave të prokurimit publik, me një vlerë të kontratave mbi 15 milionë euro.

Tabela nr.9: Kontratat e Prokurimit në Komunën e Podujevës 2010 -2012

Viti	Nr. i kontratave	Vlera e kontratave (euro)
2010	201	4.440.521,40
2011	153	7.500.667,00
2012	84	3.487.158,58
<b>Totali</b>	438	15.428.346,98

Për vitin 2012 të dhënat janë bazuar në njoftimet e KRPP

Gabimet në procedurat e prokurimit publik në Komunën e Podujevës kanë ardhur duke u zvogëluar. Gjatë vitit 2010, në adresë të Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP) kanë shkuar për t'u shqyrtuar 14 ankesa të cilat janë adresuar nga operatorët privat të cilët supozojnë se u janë shkelur të drejtat e tyre nga Komuna e Podujevës. Në tetë raste, OSHP ka nxjerrë vendime në favor të këtyre operatoreve duke konstatuar se procedurat e prokurimit nuk janë respektuar nga ana e Komunës. Në një rast OSHP ka paralajmëruar Komunën e Podujevës që do të gjobitet deri në 10.000 euro si dhe do të përjashtohet nga puna shefi i prokurimit nëse nuk përfill vendimin e këtij organi për rivlerësimin e një tenderi që ka pasur të bëjë me ndërtimin e kanalizimit fekal në fshatin Dumnicë të Poshtme.<sup>12</sup>

Gjithashtu, Auditori i Përgjithshëm ka gjetur parregullësi në sferën e prokurimit. Në raportin për vitin 2011, Auditori konstaton se në rastin e ndërtimit të kanalizimit fekal në fshatin Dumosh në vlerë prej 76.528 euro, Komuna e Podujevës kishte lidhur kontratën me operator ekonomik të papërgjegjshëm, i cili nuk i përmbushte kriteret teknike. Sipas Auditorit, në dosjen e tenderit ishte kërkuar që tenderuesit të ofronin dëshmi për pajisjet teknike, ndërsa fituesi i këtij tenderi, pajisjet i kishte me afat të skaduar të qarkullimit. Gjithashtu, te kontrata për ndërtimin e Qendrës së Mjekësisë Familjare në fshatin Lluzhan në vlerë prej 166.648 euro, fitues i kontratës nuk i plotësonte kërkesat teknike të dosjes së tenderit, duke ofruar si dëshmi teknike makineri me afat të skaduar të qarkullimit, siç ishte kërkuar në dosjen e tenderit.<sup>13</sup>

<sup>12</sup>Organi Shqyrtues i Prokurimit. Tabela me njoftimet e shpallura. Komuna e Podujevës - 2011. Burimi: [http://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2011/u\\_ndertim\\_kana\\_jan11.pdf](http://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2011/u_ndertim_kana_jan11.pdf)

<sup>13</sup>Zyra e Auditorit të Përgjithshëm. Raporti i Auditimit për Pasqyrat Financiare të Komunës Podujevës për vitin 2011. Fq 15. Burimi: [http://www.oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit\\_KPD\\_2011\\_Shqip\\_309305.pdf](http://www.oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit_KPD_2011_Shqip_309305.pdf)

## 6. Administrata e Komunës së Podujevës

Komuna e Podujevës ka gjithsej 262 persona të punësuar në administratën komunale, duke përfshirë zjarrfikësit dhe të punësuarit në Qendrën për Punë Sociale, kurse bashkë me sektorin e arsimit, ku përfshihen të punësuarit në çerdhen e qytetit, në shkollat fillore dhe ato të mesme si dhe me sektorin e shëndetësisë, numri i të punësuarve në institucionet publike është 1.975 persona.

Tabela nr.10: Numri i të punësuarve sipas sektorëve në Komunën e Podujevës dhe vështrimi gjinor

Sektorët	Numri i të punësuarve	M	F
Zyra e Kryetarit	4	3	1
Këshilli i Drejtorëve	10	10	0
Zyra e Personelit	3	2	1
Auditorit i brendshëm	2	2	0
Njësia për te Drejtat e Njeriut	2	0	2
Zyra për Integritet evropiane	1	1	0
Zyra për komunitete dhe kthim	1	1	0
Zyra për Informim	2	1	1
Zyra Ligjore	3	3	0
Zyra për përfaqësim Juridik	2	2	0
Zyra e Prokurimit	5	5	0
Zyra Pritëse	5	3	2
Zyra e Gjendjes Civile	22	17	5
Zyra për Teknologji Informative	3	2	1
Zyra e Arkivit	2	2	0
Njësia e transportit	9	9	0
Njësia për mirëmbajtje	24	17	7
Drejtoria e Inspektionit	11	10	1
Drejtoria për Buxhet dhe Financa	31	23	8
Drejtoria për Shërbime publike	26	26	0
Drejtoria për Bujqësi	21	20	1
Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadaster	17	12	5
Drejtoria e planifikimit Urban	9	6	3
Drejtoria e Shëndetësisë	8	6	2
Drejtoria e Arsimit	9	7	2
Drejtoria për Kulturë	18	16	2
Qendra për Punë Sociale	12	10	2
<b>Gjithsej</b>	<b>262</b>	<b>216</b>	<b>46</b>

Komuna e Podujevës qëndron më së keqi në krahasim me komunat e mëdha të vendit për sa i takon përfaqësimin e femrës në pozitat e punës. Përveç që asnjë femër nuk udhëheq ndonjërin nga dhjetë drejtoritë sa janë gjithsej, numri i femrave është i vogël edhe në sektorët tjerë komunal, ku siç shihet nga tabela e mësipërme nga 262 të punësuar në Komunën e Podujevës vetëm 46 prej tyre janë femra.

## 7. Arsimi në Komunën e Podujevës

Komuna e Podujevës ka 36 shkolla fillore, kurse bashkë me paralelet e ndara numri i objekteve shkollore arrin në 60. Kjo komunë, gjatë tri viteve të kaluara, ka arritur të funksionalizojë edhe çerdhen e qytetit. Në Podujevë ekzistojnë edhe katër shkolla të mesme. Në çerdhen e qytetit janë të punësuar 15 persona, ndërsa numri i fëmijëve që pranohen gjatë një viti nuk kalon 70.

Tabela nr.11: Numri i mësimdhënësve dhe stafit përcjellës në 60 shkollat fillore të Podujevës:

Gjinia	Shkolla fillore		Shkolla të mesme	
	Mësimdhënës	Stafi ndihmës	Mësimdhënës	Stafi ndihmës
Femra	419	18	56	7
Meshkuj	524	188	168	32
<b>Gjithsej</b>	<b>943</b>	<b>206</b>	<b>224</b>	<b>39</b>

Tabela nr.12: Numri total i mësimdhënësve, nxënësve dhe stafit ndihmës në 60 shkolla fillore dhe katër shkolla të mesme në Komunën e Podujevës

Kategoria	Numri	F	M
Mësimdhënës	1.167	475	692
Nxënës	21.634	10.443	11.191
Stafi ndihmës	245	25	220

Tabela nr.13: Numri total i të punësuarve në sektorët që mbulojnë nga Komuna e Podujevës

Sektorët	Numri
Komuna e Podujevës	262
Arsimi fillor dhe i mesëm	1.412
Çerdhet	15
Shëndetësia	286



Investimet në infrastrukturën e shkollave të Podujevës kryesisht janë fokusuar në riparimin e kulmeve, riparimin dhe transformimin e sistemit të ngrohjes, renovime të brendshme të shkollave, ndërrimin e dyerve dhe dritareve, plotësimin me ndonjë aneks shkollash dhe gëlqerosje të objekteve.<sup>14</sup> Megjithatë, në Komunën e Podujevës nuk është hasur ndonjë investim i dukshëm nga ana e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në vitet e fundit. Në këtë komunë është evidente edhe numri relativisht i madh i objekteve të vjetra shkollore të cilat në shumicën e rasteve nuk i përmbushin kushtet e nevojshme për mbarëvajtjen e mësimin.

## 8. Shëndetësia në Komunën e Podujevës

Sistemi i shëndetësisë në Komunën e Podujevës ka një shtrirje të gjerë dhe mbulon pothuajse gjithë territorin e komunës. Kjo komunë, përveç Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF), ka edhe 11 Qendra të Mjekësisë Familjare (QMF) dhe 10 punkte shëndetësore apo ambulanca. Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare funksionin në qendër të qytetit. Numri i të punësuarve në sistemin shëndetësor është 286 persona.

Në QKMF funksionojnë repartet e stomatologjisë, farmacisë, infermierisë, gjinekologjisë, pediatriisë, fizioterapisë, pulmologjisë dhe radiologjisë.

Gjendja e përgjithshme e shëndetësisë në Podujevë nuk dallon nga gjendja në të cilën ndodhet ky sektor në nivel të vendit. Përgjithësisht, qendrat e shëndetësisë karakterizohen me mungesa të përditshme të mjeteve të nevojshme për ofrimin e shërbimeve për pacientët. Megjithatë, nuk kanë munguar investimet në shëndetësi në tri vitet e fundit, ku është ndërtuar objekti i ri i QMF në fshatin Lluzhan, dhe në fshatin Penu. Gjithashtu, ndërtesa e QKMF dhe shtatë objekte tjera të QMF janë gëlqerosur.

## 9. Transparenca në Komunën e Podujevës

Komuna e Podujevës ka shënuar progres të theksuar gjatë tri viteve të kaluara për sa i përket transparencës komunale. Ueb faqja zyrtare e Komunës posedon materiale dhe informata të shumëllojshme për shumicën e sferave që mbulon Komuna dhe po ashtu

---

<sup>14</sup> Komuna e Podujevës. Plani i investimeve për vitin 2010 dhe 2011. Fq 3. Burimi: <http://kk.rks.gov.net/podujeve/getattachment/30003697-24d3-4318-a972-c45139f7c841/Raport--mbi-gjendjen-ekonomike-dhe-realizimin-e-pl.aspx>

janë të publikuara edhe raportet financiare të këtij institucioni, si në lëminë e të hyrave ashtu edhe atë të shpenzimeve të parasë publike. Komuna është treguar transparente dhe e përgjegjshme edhe ndaj kërkesave të Institutit GAP për qasje në dokumentet publike.

Një hap inkurajues në këtë aspekt është përpjekja e Kryetarit të Komunës për të bashkëbiseduar me banorët e zonave të Podujevës, ku në shumicën e rasteve ka bërë edhe prezantimin e pasqyrave financiare për sa i takon të hyrave, por edhe shpenzimeve. Po ashtu, vlerësohet e kënaqshme edhe sasia e informatave që korrespondentët e medieve të shkruara marrin nga Zyra për Marrëdhënie me Publikun. Podujeva nuk ka ndonjë medium lokal i cili do të mund të mbulonte zhvillimet e përditshme në këtë lokalitet.

Tabela: nr.14: Vlerësim i përmbajtjes së ueb faqes së Komunës së Podujevës

<http://kk.rks-gov.net/podujeve/>

Dokumenti	2010				2011				2012			
	I	II	III	IV	I	II	III	IV	I	II	II I	I V
Raporti i Punës së Kryetarit	x	x	x	x	x	X	x	√	x	x	x	x
Raporti financiar (buxhetor) i Komunës	x	√	x	√	x	√	x	√	x	x	x	x
Raportet e Drejtorisë së Administratës	x	x	x	x	x	x	x	√	x	x	x	x
Raportet e Drejtorisë së Arsimit	x	x	x	x	x	x	x	√	x	x	x	x
Raportet e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale	x	x	x	x	x	X	x	√	x	x	x	x
Raportet e Drejtorisë së Inspektionit	x	x	x	x	x	X	x	x	x	x	x	x
Drejtoria për Buxhet dhe Financa	x	√	x	√	x	X	x	x	√	x	x	x
Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër	x	x	x	x	x	X	x	x	√	x	x	x
Drejtoria për Shërbime Publike	x	x	x	x	x	X	x	√	x	x	x	x
Planifikim dhe Urbanizëm	x	x	x	X	x	X	X	√	x	x	X	x
Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport	x	x	x	X	x	X	x	√	X	x	X	x
Drejtoria e Bujqësisë	x	x	x	x	x	X	x	√	√	√	√	x
Zyra e Prokurimit	√				√				√			
Raportet e Njësisë së Auditimit të Brendshëm	√				√				x			

Procesverbalet e Kuvendit Komunal	√						√						√	
Rregulloret Komunale	√						√						√	
Vendimet e Kuvendit Komunal	√						√						√	
Rregullorja e Punës së Kuvendit Komunal	√													
Procesverbalet e Komitetit për Politikë dhe Financa	x	x	x	x	x	X	x	x	x	x	x	x		
Planet dhe Strategjitë e Komunës	√													

X = mungon raporti. √= raporti është i publikuar në ueb-faqe.

## 10. Përmbushja e premtimeve të fushatës zgjedhore 2009

Gjatë fushatës zgjedhore 2009, kandidati për kryetar komune, tani Kryetari i Komunës z. Agim Veliu, para elektoratit të tij ka shpalosur premtime në sfera të ndryshme. Pas monitorimit të të gjitha premtimeve të dala nga fushata zgjedhore, Instituti GAP dhe BIRN, në fund të vitit 2010 i kanë shkruar letër të hapur Kryetarit të Komunës të cilit iu përkujtuan edhe një herë premtimet e dhëna, duke kërkuar njëkohësisht realizimin e tyre.

Tabela e mëposhtme vlerëson progresin e arritur në realizimin e premtimeve të dhëna në vitin 2009. Në këtë tabelë janë përfshirë 41 premtime të dhëna. Në bazë të hulumtimit të GAP del se pas tri viteve të qeverisjes në Komunën e Podujevës, 17 premtime janë përmbushur, 15 nuk janë përmbushur, ndërsa në 9 premtime ka pasur nisma dhe rezultate evidente, por nuk mund të konsiderohen akoma premtime të përmbushura.

Premtimet e dhëna më 2009	Realizimi i premtimeve gjatë 2010-2012
Lirim nga ngarkesat komunale për bizneset te cilat dëshmojnë se e kanë rritur numrin e të punësuarve	Në këtë drejtim komuna nuk ka bërë asnjë hap. Ngarkesat komunale për bizneset janë të njëjta, pavarësisht numrit të punëtoreve që kanë.
Subvencione për artizanate të vjetra	Komuna praktikisht nuk ka ndërmarrë asnjë veprim me të cilin do të ndihmoheshin artizanatet dhe të mos rrezikohej shuarja e tyre.
Hapje të punkteve shëndetësore në qendrat më të mëdha jashtë qytetit, si në Kërpimëh, Orllan dhe Lluzhan	Sa i përket këtij premtimi janë përmbush thujse plotësisht objektivat. Punktet në Kërpimëh dhe në Lluzhan janë hapë ndërsa në Orllan është në përfundim e sipër. Qendra e Lluzhanit është projekti i cili kap shumën 166.648 euro ku me 100 mijë euro ka financuar organizata nga Kuvajti "KAD" ndërsa me shumën tjetër Komuna e Podujevës.
Asfaltimin e rrugës në fshatin Surkish, shtrirjen e gypave të kanalizimit dhe ndërtimin e një shkolle	Asfaltimi i fshatit Surkish ka përfunduar në dhjetor 2011. Rruga në gatësi prej 2.660.00 metra i ka kushtuar Komunës së Podujevës 138.988.42 euro. Shtrimi i gypave të kanalizimit ka nisur pjesërisht në disa zona të këtij fshati, ndërsa shkolla nuk është ndërtuar.

Ndërtimin e një shkolle dhe një stacioni autobusësh për lagjet në pjesën “Podujeva II”	Edhe pse është dhënë pëlqimi nga ana e kuvendit për ndërtimin e stacionit të autobusëve në atë pjesë asgjë nuk është bërë tash e dy vite. Shkolla është në fazën përfundimtare, por është investim i MASHT-it.
Rregullimin e trotuareve dhe asfaltimin e të gjitha rrugëve dhe rrugicave të qytetit	Ky premtim mund të vlerësohet i përmbushur ngase rezulton se pjesa më e madhe e rrugëve në qytet janë asfaltuar, ndonëse disave u mungon trotuari dhe ndriçimi publik.
Gjatë dy viteve të para të qeverisjes, Podujeva do të shndërrohet në qytet Evropian.	Pamja e qytetit të Podujevës ka ndryshuar rrënjësisht në kuptimin pozitiv, por krahasimi i imazhit të qytetit me qytetet evropiane është vështirë i matshëm dhe premtimi në këtë drejtim ka më shumë premisa të retorikes politike.
Ngritjen e cilësisë së arsimit: kompjuterizim dhe digjitalizim të shkollave, ngritje profesionale dhe menaxheriale, autonomi për shkollat, objekte dhe hapësira më të mëdha, kujdes të veçantë për nxënësit me nevoja të veçanta	Shkollat përgjithësisht janë kompjuterizuar, por jo edhe digjitalizuar. Autonomia për shkolla është në proces, disa shkolla tanimë e gëzojnë këtë të drejtë. Nxënësit me nevoja të veçanta u është kushtuar vëmendje, përkatësisht për këtë kategori nga komuna është siguruar transporti falas.
Përkujdesje për pensionistët	Nuk është bërë asgjë sa i përket përkujdesjes për pensionistët.
Partneritet me subjekte afariste private	Nuk ka pasur ndonjë hap të rëndësishëm nga ana e komunës në këtë drejtim.
Zhvillim të ekonomisë dhe bujqësisë	Zhvillimi ekonomik nuk është shumë kompetencë e nivelit lokal, përjashtimisht lehtësirave që mund t’i ofrojnë komunat për funksionimin më të mirë të biznesit. Në bujqësi, komuna më shumë ka luajtur rolin e koordinatorit mes bujqve dhe Ministrisë së Bujqësisë së Qeverisë së Kosovës dhe nuk është vërejtur ndonjë nismë konkrete e komunës për t’i ndihmuar bujqit e kësaj ane.
Asfaltimin e rrugës për fshatin Dumnicë e Epër me dhe rregullimin e urës mbi lumin e fshatit	Këto projekte kanë përfunduar.
Furnizim stabil me ujë të pijshëm	Furnizimi me ujë të pijshëm është problemi kryesor që ballafaqohet komuna gjatë kësaj qeverisje. Ndonëse u është premtuar se do të ketë ujë, pothuajse i tërë qyteti ballafaqohet me mungesën e ujit të pijes.
Vendosjen e një kolektori të ujërave të zeza në pjesëne qytetit të lumit Llap	Nuk është bërë asgjë sa i përket rregullimit të impiantit, ujërat e zeza derdhen pa kurrfarë kontrolli në lumin Llap.

Më shumë hapësirë për integrimin e femrave	Premtim i pa përmbushur. Nga 10 Drejtori sa ka komuna asnjëra nuk udhëhiqet nga femrat dhe po ashtu nga 262 të punësuar në administratën komunale, vetëm 46 prej tyre janë femra.
Për fshatin Dumosh rregullimin e kanalizimit	Projekt i përfunduar.
Dhënien falas të barnave për ata që janë në kushte të rënda sociale	Premtim i përmbushur. Disa barna ofrohen pa pagesë nga ana e QKMF në Podujeve, por kjo është e sponsorizuar nga Ministria e Shëndetësisë e Qeverisë së Kosovës nëpërmjet të ashtuquajturës lista esenciale.
Ndërtimin e 10 shtëpive çdo vit për familjet skamnore komunës	Komuna për çdo vit ka ndërtuar nga 10 shtëpi për familjet skamnore, por në ndihmë i kanë dalë edhe donatorë të ndryshëm.
Asfaltimin e rrugës së Herticës	Rruga 12 kilometërshe deri në Herticë është në përfundim e sipër, por edhe ky projekt është investim i Qeverisë i cili ka kushtuar mbi 5 milion euro.
Për fshatin Shajkofc ndërtimin e shkollës së re, përfundimin e kanalizimit dhe trotuarit	Rruga, trotuari dhe kanalizimi mund të vlerësohen të përmbyllura për fshatin Shajkofc, por jo edhe ndërtimi i shkollës.
Ndërtimin e një qendre të madhe të mjekësisë familjare, me laboratorë për analiza bazike dhe ordinancë stomatologjike në fshatin Kërpimëh	QMF është ndërtuar dhe kohë pas kohe funksionon ordinanca stomatologjike
Ndërtimin e rrugëve dhe kanalizimin për fshatin Sfecël, zgjidhjen e problemit të ujërave të zeza	Kanë filluar të ndërtohen rrugët dhe kanalizimi në fshatin Sfecël por ende nuk kanë përfunduar.
Ndërtimin e rrugës që lidh fshatin Sfecël me fshatin Sekiraqë	Nuk është ndërtuar.
Për banorët e fshatit Obrancë asfaltimin e rrugës Obrancë-Peran, përmirësim të infrastrukturës dhe ujësjellësit	Është bërë asfaltimi i rrugës që lidh fshatin Obrancë-Peran, por nuk është përmirësuar rrjeti i kanalizimit dhe ujësjellësit.
Për fshatin Llapashticë: asfaltimin e rrugës Llapashticë- Katunishtë dhe rinovimin e shkollës së fshatit	Është bërë asfaltimi i rrugës e po ashtu edhe renovimi i shkollës së fshatit.
Për banorët e Shtedimit kyçje në ujësjellës, ndërtimin e rrugës Livadicë-Dumnicë dhe	Në fshatin Shtedim është bërë kyçja në fshatin e ujësjellësit ndërsa rrugët Livadicë-Dumnicë dhe rruga Shtedim-Mirofc nuk janë ndërtuar.

rrugës Shtedim-Mirofc	
Për fshatin Peran: bërjen me gjithë infrastrukturën e nevojshme	Ka pasur investime të dukshme në infrastrukturë, kanalizim dhe ujësjellës për këtë fshat.
Për fshatin Dyz dhe fshatrat tjera të asaj ane asfaltimin e rrugëve, ujësjellësit dhe kanalizime;	Rrugët janë asfaltuar ndërsa sa i për këtë kanalizimit dhe ujësjellësit nuk është investuar asgjë
Krijimin e hapësirave gjelbëruese	Gjatë tri viteve të kaluara i është kushtuar një vëmendje më e madhe gjelbërimit dhe mirëmbajtjes së tij. Projekti më i madh në këtë drejtim mbetet ai për rregullimin e parkut të qytetit.
Një lokacion për stadiumin e ri të qytetit, kurse stadiumit ekzistues do t'i ndryshohet destinimi për shkak të pozitës jo të përshtatshme	Asgjë në këtë drejtim nuk është bërë.
Ndërtimin e një qendre të madhe të kulturës	Komuna e Podujevës tash e 12 vite nuk ka qendër të vogël të kulturës
Themelimin e një muzeu të qytetit për të ruajtur dhe konservuar gjërat e vjetra dhe të çmueshme të Llapit	S'është bërë asgjë në këtë drejtim.
Ndërtimin e shkollës në Metehi	Nuk ka ndërtim të shkollës në Metehi.
Ndërtimin e qendrave të reja të mjekësisë familjare	Premtim i përmbushur.
Promovimin e kulturës dhe jetës sportive për të rinjtë	Nuk është bërë aq shumë për promovimin e jetës kulturore dhe sportive për të rinjtë.
Zhvillimin dhe modernizimin e administratës komunale	Nuk ka pasur ndonjë investim apo plan konkret që do të mund të merrej si indikacion i modernizimit të administratës komunale.
Rregullimin e transportit urban dhe urbano - periferik	Nuk është bërë asgjë për trafikun urban dhe atë urban-periferik. Shumë taksive veprojnë në mënyrë të kundërligjshme dhe ende nuk është marrë asgjë nga komuna që të rregullojë këtë gjendje. Vlen të cekët se taksitë që veprojnë në mënyrë të kundërligjshme që bëjnë transportin Podujevë -Prishtinë dhe anasjelltas, jo vetëm që janë ilegal por edhe parkohen në trotuar dhe ngecin komunikacionin dhe vështirësojnë kalimin e qytetarëve.
Ngritja e kapaciteteve njerëzore në shërbimin civil	Nuk shihet ndonjë përmirësim në këtë drejtim.

Miratimin e rregulloreve dhe harmonizimi i tyre me ligjet e miratuara	Çështja e rregulloreve nuk është kompetencë e Kryetarit, por e Kuvendit komunal dhe premtimi në këtë drejtim është i kotë, madje edhe premtimi që rregulloret do të harmonizohen me ligjet në fuqi është i kotë, ngase asnjë rregullore komunale nuk mund të nxirret pa pasur bazë ligjore.
Ngritjen e transparencës për vendimmarrje	Ka një ngritje të dukshme. Premtim i përmbushur.
Ofrimin e shërbimeve cilësore në shëndetësi	Në sferën e shëndetësisë ka pasur disa investime të cilat kanë ndikuar në përmirësimin e kushteve teknike, por vlerësimi i cilësisë së shërbimeve në këtë sferë nuk e dallojnë Komunën e Podujevës nga komunat tjera të vendit.



## 11. Burimet

1. Komuna e Podujevës. Raporti Financiar janar – dhjetor 2010. Burimi: [http://kk.rks.gov.net/podujeve/getattachment/c1cb16b9-f5e9-4da4-89ad-008e22a78c29/Drejtoria-per-Buxhet,Financa,Planfikim-dhe-Zhv-\(1\).aspx](http://kk.rks.gov.net/podujeve/getattachment/c1cb16b9-f5e9-4da4-89ad-008e22a78c29/Drejtoria-per-Buxhet,Financa,Planfikim-dhe-Zhv-(1).aspx)
2. Komuna e Podujevës. Raporti Financiar janar – dhjetor 2011. <http://kk.rks.gov.net/podujeve/Shpalljet/Raportet.aspx>
3. Komuna e Podujevës. Drejtoria për Buxhet dhe Financa. Raporti i shpenzimeve të buxhetit janar – shtator 2012.
4. Komuna e Podujevës. Drejtoria e Administratës. Lista e të punësuarave në administratën komunale 2012.
5. Komuna e Podujevës. Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale. Lista e të punësuarave në sektorin e shëndetësisë primare në Podujeve.
6. Komuna e Podujevës. Drejtoria për Buxhet dhe Financa. Shpenzimet për mallradhesherbime 2011 dhe janar – shtator 2012.
7. Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë. Statistikat e Arsimit në Kosovë 2011. Burimi: <http://www.masht.gov.net/advCms/documents/11052012.pdf>
8. Raportet vjetore 2011 të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik - [http://krpp.rks.gov.net/Default.aspx?PID=Home&LID=1&PCID=-1&CtlID=HTMLStatic&CID=PPRCannual&PPRCMenu\\_OpenNode=90](http://krpp.rks.gov.net/Default.aspx?PID=Home&LID=1&PCID=-1&CtlID=HTMLStatic&CID=PPRCannual&PPRCMenu_OpenNode=90)
9. Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik. Njoftimet për lidhjen e kontratave përmes prokurimit publik nga Komuna e Podujevës. Burimi: <https://krpp.rks.gov.net/Default.aspx?PID=Notices&LID=1&PCID=-1&CtlID=ViewNotices&ID=67342>
10. Agjencia e Statistikave të Kosovës. Rezultatet përfundimtare për Regjistrimin e Popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave - 2011. Burimi: [http://esk.rks.gov.net/rekos2011/repository/docs/Te%20dhenat%20kryesore\\_ALB.pdf](http://esk.rks.gov.net/rekos2011/repository/docs/Te%20dhenat%20kryesore_ALB.pdf)
11. Komuna e Podujevës. Ueb faqja zyrtare. Demografia e Komunës së Podujevës. Burimi: <http://kk.rks.gov.net/podujeve/City-guide/Geography.aspx>
12. Kuvendi i Kosovës. Ligji për Financat e Pushtetit Lokal. Burimi: [http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2008\\_03-L049\\_al.pdf](http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2008_03-L049_al.pdf)
13. Instituti për Studime të Avancuara GAP. Të dhënat e Regjistrimit të Popullsisë dhe ndikimi i tyre në Politikat Publike. Burimi: <http://institutigap.org/repository/docs/GAPanalizepertedhenateASK.pdf>
14. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm. Raporti i Auditimit për Pasqyrat Financiare të Komunës së Podujevës për vitin 2011. Fq 14. Burimi: [http://www.oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit\\_KPD\\_2011\\_Shqip\\_309305.pdf](http://www.oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit_KPD_2011_Shqip_309305.pdf)
15. Organi Shqyrtues i Prokurimit. Tabela me njoftimet e shpallura. Komuna e Podujevës - 2011. Burimi: [http://oshp.rks.gov.net/repository/docs/vendimet/2011/u\\_ndertim\\_kana\\_jan11.pdf](http://oshp.rks.gov.net/repository/docs/vendimet/2011/u_ndertim_kana_jan11.pdf)
16. Komuna e Podujevës. Raporti i Punës i Kryetarit për vitin 2011. Burimi: <http://kk.rks.gov.net/podujeve/getattachment/30003697-24d3-4318-a972-c45139f7c841/Raport--mbi-gjendjen-ekonomike-dhe-realizimin-e-pl.aspx>